






Raporti (janar – mars) 2020



Fushë Kosovë
Maj 2020

Aktivitetet kryesore dhe struktura organizative e INFRAKOS-it



Përmbajtja

1. Aktivitetet kryesore dhe struktura organizative	3
1.1 Aktivitetet kryesore të INFRAKOS-it	3
1.2 Struktura organizative e INFRAKOS-it	6
2. Performanca afariste e INFRAKOS-it	8
2.1 Departamenti i komunikacionit	9
2.2 Departamenti i MLH	12
2.3 Departamenti i VET	16
2.4 Zyra e planifikimit dhe zhvillimit	18
2.5 Departamenti i administratës	20
2.6 Departamenti i MPM, SHMP dhe IT	21
2.7 Departamenti për pronë dhe standarde	23
2.8 Departamenti i prokurimit	25
2.9 Kontrollori i brendshëm	26
3. Performanca financiare e INFRAKOS-it	29
3.1 Të hyrat	30
3.2 Shpenzimet	31
3.3 Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve	31
4. Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it	32
5. Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it për kuartalin vijues	34
6. Transaksionet financiare gjatë kuartalit të parë	35
7. Sugjerimet për ngritjen e performancës	37

1.1 Aktivitetet kryesore të INFRAKOS-it

Vitin 2020 INFRAKOS-i e ka filluar me shumë sfida të cilat falë angazhimeve maksimale të të gjithë stafit janë tejkaluar dhe po tejkalohen me sukses. Por problemi tanimë i vazhdueshëm i ndërlidhur me gjendjen tejet të vështirë financiare me dhe pa fajin e INFRAKOS-it na ka përcjellë edhe në kuartalin e parë të vitit. Si zakonisht edhe këta tre muaj, prioriteti kryesor ka qenë i orientuar në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore ashtu që të mundësohet qarkullimi i trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave pa problem dhe në mënyrë të sigurt. Një punë tjetër e madhe është bërë edhe në departamentet dhe sektorët tjerë mbështetës rreth financave, patundshmërisë, planifikim zhvillimit dhe ngritjeve të kapaciteteve njerëzore. Një punë tjetër e rëndësishme së veçantë ka qenë e lidhur me bashkëpunimin dhe bashkërenditjen e veprimeve me institucionet përgjegjëse të shtetit lidhur me MSA-në, Programin e Reformave Ekonomike, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit, realizimin e detyrave të parapara me planin e veprimit të Komitetit Teknik mbi Hekurudhat të Komunitetit të Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor, duke plotësuar dhe dorëzuar me kohë të gjitha raportet, informatat dhe të dhënat e ndryshme të kërkuara nga institucionet përkatëse.

Gjatë këtij tremujori është bërë një punë e madhe edhe në hartimin, miratimin dhe dorëzimin me kohë të raportit vjetor për vitin 2019, raportit mbi kënaqshmërinë e klientëve, raportet mujore, si dhe hartimi i Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2021 që paraqet dokumentin kryesor të kompanisë për përcaktimin e kushteve mbi ofrimin e shërbimeve për operatorët e transportit hekurudhor dhe pagesat e qasjes në binarë.

Mirëpo veçantia e këtij tremujori ndërlidhet me muajin mars ku është shpallur situatë emergjente për shkak të pandemisë botërore për shkak të corona virusit i cili në këtë muaj është përhapur edhe në Kosovë. Me vendim të Qeverisë së Kosovës që nga data 13.03.2020 është ndërprerë qarkullimi i trenave të udhëtarëve, ndërsa mbeten në qarkullim vetëm trenat e mallrave. INFRAKOS-i ka qenë gjatë tërë kohës i angazhuar në përcjelljen e situatës duke punuar me staf të reduktuar por të domosdoshëm për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore dhe organizimin e qarkullimit të trenave.

Një çështje tjetër e cila vlen të përmendet për këtë tremujor ndërlidhet edhe me shkarkimin e Bordit të Drejtorëve të INFRAKOS-it të cilin e ka bërë Qeveria e Kosovës me datën 27.02.2020 e që deri në fund të muajit mars akoma nuk është bërë emërimi i bordit të ri.

1.1.1 Raportimi

Njëri ndër obligimet e shumta të INFRAKOS-it është i ndërlidhur me raportimin e rregullt për bordin e drejtorëve dhe institucionet përgjegjëse shtetërore lidhur me gjendjen e kompanisë dhe zhvillimet e ndodhura për periudha të caktuara kohore.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti INFRAKOS-i ka hartuar Raportin vjetor për vitin 2019 dhe i njëjti pas miratimit nga Bordi është dërguar në Njësinë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike. Përveç raportit vjetor të vitit 2019, gjatë kësaj kohe janë hartuar dhe dorëzuar edhe raportet mujore për muajin janar dhe shkurt të

vitit 2020, duke përbushur kështu edhe obligimet e raportimit për periudhën tremujore të këtij viti.

Sa i përket raportimit vlen të përmendet edhe hartimi dhe dorëzimi i raportit mbi kënaqshmërinë e klientëve, raport ky tejet i rëndësishëm përmes të cilit përcaktohet dhe vlerësohet puna e kompanisë tonë sidomos në sektorët të cilët ofrojnë shërbime të ndryshme, duke filluar nga sektori i komunikacionit për ofrimin e shërbimeve të organizimit të trafikut të trenave, ofrimin e shërbimeve tjera për operatorët e transportit hekurudhor, e deri te ofrimi i shërbimeve në terminalin e mallrave. Më pastaj vjen ofrimi i shërbimeve të cilat i bënë sektori i patundshmërisë dhe kanë të bëjnë me dhënien me qira të banesave të INFRAKOS-it, lokaleve të ndryshme dhe pronës tjetër të kompanisë. Me një fjalë, raporti i kënaqshmërisë tregon se gjatë vitit 2019 ka pasur një ngritje dhe përmirësim të shërbimeve të cilat i ofron INFRAKOS-i, e kjo tregon për angazhimin e shtuar të kompanisë karshi klientëve tonë.

1.1.2 Hartimi i Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2021

Përveç detyrave të përditshme në mirëmbajtje dhe organizim të transportit hekurudhor, gjatë tremujorit të parë të këtij vitit është bërë edhe hartimi i njërit nga dokumentet më të rëndësishme të kompanisë: Ekspozeu i Rrjetit për vitin 2021. Ky Ekspoze është përpiluar në bazë të kreut IV të Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063, respektivisht nenit 55, 61, 62, 64 dhe 65 të këtij ligji, si dhe Udhëzimeve Administrative të Ministrisë së Infrastrukturës nr. 1991/13 dhe atë me nr. 1992/13 të datës 28.06.2013.

E veçanta e këtij Ekspozeu është se i njëjti është hartuar në pajtim me propozimet e ekspertëve të jashtëm të EGIS BCOM të cilët të financuar nga BERZH-i gjatë vitit 2018 e kanë realizuar projektin mbi TAC & AMP (Pagesat e Qasjes në Binarë & Planin mbi Menaxhimin e Aseteve) për INFRAKOS-in.

Vlen të përmendet se INFRAKOS-i ua ka dërguar Ekspozeun e Rrjetit 2021 të gjitha palëve të interesit dhe bazuar në nenin 58 të Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063, ka filluar procesin e konsultimit me të gjitha palët e interesit të parapara me këtë ligj.

1.1.3 Hartimi i Ekspozeut të Rrjetit të Terminalit të Mallrave për vitin 2021

Gjatë këtij tremujori është bërë edhe hartimi i Ekspozeut të Rrjetit mbi Terminalin e Mallrave për vitin 2021 në të tria gjuhët dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen e kompanisë. Me këtë ekspoze bëhet përcaktimi i kushteve dhe tarifave mbi ofrimin e shërbimeve në Terminalin e Mallrave në Miradi për të gjitha palët e interesit të cilat dëshirojnë ta shfrytëzojnë këtë terminal për transportin e mallrave.

1.1.4 Linja e 10 (dhjetë) hekurudhore

Gjatë këtij tremujori ka vazhduar puna në realizimin e projektit të rehabilitimit të linjës së 10 hekurudhore (Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Ndër punët dhe detyrat e realizuara gjatë këtij tremujori vlen të përmenden:

- ➔ Ka vazhduar rehabilitimi i pjesës jugore (fazës së parë) të kësaj linje hekurudhore (Fushë Kosovë – Hani i Elezit), por për shkak të pandemisë së corona virusit që nga data 14.03.2020 është bërë ndërprerja e punimeve;
- ➔ Gjatë këtij tremujori është përfunduar projekt dizajni detaj teknik për fazën e 2-të, kështu që tani janë duke përfunduar procedurat për përzgjedhjen e kompanisë e cila do të bënë rehabilitimin e fazës së 2-të me ç'rast pritet që të dorëzohen ofertat financiare sipas afatit të paraparë. Kjo duhet të bëhet deri në muajin maj.

1.1.5 Linja hekurudhore e aeroportit

Njëri ndër projektet e rëndësishme të infrastrukturës hekurudhore është edhe lidhja me hekurudhë e Prishtinës me Aeroportin e Prishtinës “Adem Jashari”. Për këtë projekt të rëndësishëm të financuar nga grantet e WBIF-it kemi qenë në përgatitje të realizimit të opsionit “B” të intervistimit i cili pritet të organizohet në kuartalin e parë të 2020, afati i përfundimit varet nga situata në teren si shkak i COVID 19.

1.1.6 Linja e 7-të Hekurudhore

Projekt Dizajni Preliminar i Linjës së 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Prishtinë - Podujevë – Kufiri me Serbinë) është në fazën e inkorporimit të një numri të madh të komenteve, ka mbetur të bëhet definimi i pronës për të inkorporuar zgjidhjen për dizajnin e stacionit në Prishtinë dhe hyrjen e evakuimit në raste emergjente për Tunelin që lidhë Prishtinën me Bardhoshin. Me një fjalë, projekti është në proces dhe afati i përfundimit varet nga situata në teren si shkak i COVID 19.

1.1.7 Projekti i mbështetjes së PIU-së

Nënshkrimi i kontratës me Egis - International-KEG, Assistance to PIU është bërë me 23/01/2020, dhe po zhvillohet me kujdes dhe duke respektuar kërkesat e OBSH-së për shkak të COVID 19.

1.1.8 Mirëmbajtja e infrastrukturës

Gjatë këtij tremujori të gjithë sektorët e INFRAKOS-it kanë pasur një angazhim të veçantë në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, sidomos në kohën me temperatura të ulëta gjatë dimrit, ashtu që komunikacioni hekurudhor të zhvillohet pa problem. Angazhimi i të gjithë punonjësve për realizimin e detyrave të parashtruara ka qenë shumë i madh, andaj gjatë këtij tremujori nuk kemi pasur asnjë ndërprerje apo problem tjetër në qarkullimin e trenave për shkak të infrastrukturës. Për më tepër, të gjitha kërkesat e operatorëve të transportit (TRAINKOS dhe RAILTRANS) për trena të jashtëzakonshëm të udhëtarëve dhe të mallrave janë realizuar menjëherë. Përfundimisht, gjatë këtij tremujori përveç aktiviteteve të përmendura më lartë, janë zhvilluar edhe një numër i madh i aktiviteteve tjera të ndërlidhura me mirëmbajtjen, zhvillimin, funksionimin më të mirë dhe në tërësi për ngritjen e performancës së INFRAKOS-it.

1.2 Struktura organizative e INFRAKOS-it

Struktura organizative e INFRAKOS-it në fund të tremujorit të parë të këtij vitit nuk ka pësuar ndonjë ndryshim dhe është e njëjtë me strukturën organizative të kuartalit paraprak. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - INFRAKOS gjatë periudhës kohore prej tre muajve (janar – mars) 2020 sa i përket numrit të të punësuarve ka pasur ndryshime për shkak të pranimin në punë të një numri të konsideruar të punëtorëve të rinj, kështu që në fund të muajit mars 2020 numri i punonjësve në INFRAKOS ka qenë 316, duke mos i llogaritur edhe katër anëtarët e bordit të drejtorëve.

Objektivat sipas planit të biznesit për të cilat ka pasur angazhim maksimal për realizimin e tyre janë prezantuar në vijim:

- Menaxhimi i rregullt i resurseve njerëzore (punësimi, largimi, pensionimi);
- Pagat dhe kompensimet tjera të punëtorëve;
- Disiplina në punë;
- Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punëtorët dhe palët e interesuara; dhe
- Planifikimi dhe mbikëqyrja administrative e shfrytëzimit të pushimeve vjetore.

Menaxhimi i rregullt i Resurseve njerëzore (punësimi, largimi, transferimi, pensionimi etj) - Gjatë periudhës kohore tre mujore janar - mars 2020 janë realizuar të gjitha detyrat të ndërlidhura me menaxhimin e resurseve njerëzore. Sektori i RNJ ka bërë rregullisht evidentimin dhe menaxhimin e çështjeve më të rëndësishme të cilat ndërlidhen me punësimet e reja, vazhdimin e kontratave, konkurseve të brendshme, ndërprerjet e punës, organizimin e punës për praktikantë, evidentimin dhe përgatitjen e listave të pagave e kështu me radhë.

Punësimi - Në fillim të muajit janar 2020 INFRAKOS-i i ka pasur të punësuar 298 punëtorë dhe 6 anëtarë të Bordit të Drejtorëve, ndërsa me 16/01/2020 është publikuar konkurs për pranimin e punëtorëve të rinj. I njëjti konkurs i shtypur edhe në gjuhën serbe është përsëritur edhe me 31/01/2020. Konkursi është shpallur për pozitën:

- Ndërrues të binarëve – praktikant (9 pozita)
- Drejtues të lëvizjes së trenave – praktikant (6 pozita)
- Zyrtar ligjor (1 pozitë)
- Ekonomist i diplomuar praktikant (1 pozitë)

Pas përfundimit të procedurave të konkursit komisionet e përzgjedhjes kanë pranuar në punë 13 punëtorë në pozitën e drejtuesit të trenit, 12 punëtorë në pozitën e ndërruesve të binarëve dhe dy (2) punëtorë në shërbimet administrative.

Procedurave të konkursit publik me kërkesë për tu sistemuar në pozitë tjetër në shërbimet ekzekutive iu kanë nënshtruar edhe shumë punëtorë ekzistues prej të cilëve pesë janë përzgjedhur (katër për pozitën drejtues treni dhe një për pozitën ndërrues i binarëve).

Transferimi – Gjatë këtij tremujori janë bërë edhe disa transferime të punonjësve nëpër pozita dhe vende të ndryshme. Transferimet e bëra janë prezantuar në vijim:

- Këshilltari juridik i KE-së kalon në pozitën e udhëheqësit të zyrës ligjore
- Udhëheqësi i zyrës ligjore kalon në pozitën e këshilltarit juridik të KE-së.
- Shefi i shërbimit të mirëmbajtjes së ndërtesave, në pozitën e shefit të shërbimit të njësive të MLH.
- Mbikëqyrësi i parkut të automjeteve kalon në pozitën e shefit të shërbimit të mirëmbajtjes së ndërtesave
- Njëri nga vozitësit kalon në pozitën e mbikëqyrësit të parkut të automjeteve
- Asistentja e KE-së kalon në pozitën e zyrtares për menaxhimin e kontratave
- Zyrtari për koordinim të marrëdhënieve me jashtë kalon në pozitën furnizues (në këtë pozitë është sistemuar në fillim të muajit prill).
- Rojtari i vendkalimit në Ferizaj (I kontraktuar me Komunën e Ferizajit) përkohësisht është transferuar në pozitën ndërrues i binarëve në stacionin Hekurudhor Hani i Elezit.

Ndërprerje e marrëdhënies së punës - Pas plotësimit të kushteve për pension nga numri i përgjithshëm i punëtorëve pensionohen katër punëtorë:

- Një ndërrues i binarëve;
- dy drejtues të lëvizjes së trenave
- Një punëtor i MLH.

Disiplina në punë - Gjatë periudhës tre mujore kemi pasur një lëndë për komision disiplinor. Për shkelje të detyrave të punës me ç'rast komisioni disiplinor ka dhënë vërejtje me shkrim.

Ofrimi i shërbimeve dhe informatave të nevojshme për punëtorët dhe palët e interesuara – Resurset njerëzore edhe gjatë këtij tremujori kanë kryer në vazhdimësi punë rreth pajisjes së punëtorëve, ish punëtorëve, anëtarëve të familjeve të tyre dhe personave të parë me dokumentacion për nevojat e tyre personale.

Përcjellja e pushimeve vjetore, mjekësore dhe pushimeve tjera statusore - Për periudhën tre mujore janar - mars, resurset njerëzore janë marrë edhe me menaxhimin e pushimeve vjetore të punëtorëve. Resurset njerëzore kanë bërë në mënyrë të rregullt zbatimin e kërkesave të punonjësve për pushim vjetor

Shkrimorja dhe arkivi – Në protokollin e punës të shkrimores së INFRAKOS-it brenda kësaj periudhe kanë qarkulluar këto lëndë të natyrave të ndryshme:

Të gjitha shkresat e regjistruar në protokollin e brendshëm, protokollin e shkurtër librin e faturave dhe librin për dërgimin e postës gjithsejtë janë: 69 kërkesa hyrëse, janë 21 lëndë nga gjykata 38 fatura hyrëse, lëndët e punuara brenda dhe shpërnda jashtë janë 13 dhe lëndët e punuara brenda dhe shpërndara brenda janë 23, ndërsa dërgesa me poste 13.



***Performance afariste
e INFRAKOS-it***

2.1 Departamenti i komunikacionit

Departamenti i komunikacionit gjatë muajve (janar – mars) 2020 vazhdimisht është marrë me ofrimin e shërbimeve për nevoja të operatorëve të transportit hekurudhor (TRAINKOS – it dhe RAILTRANS-it), veçanërisht me përcjelljen dhe rregullimin e lëvizjes së sigurt të trenave, qoftë të atyre të udhëtarëve apo qoftë të atyre të mallrave.

Departamenti i komunikacionit ka punuar me një angazhim 24 (njëzetekatër) orësh për rregullimin dhe mbikëqyrjen e komunikacionit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave, duke u kujdesur që çdo gjë të jetë në nivelin e duhur dhe të zbatohet me përpikëri orari i lëvizjes së trenave.

Falë angazhimeve maksimale, gjatë këtyre tre muajve nuk kemi pasur asnjë vonesë apo anulim të qarkullimit të trenave për shkak të këtij departamenti. Për më tepër, çdo kërkesë e operatorëve të transportit hekurudhor TRAINKOS-it apo RAILTRANS-it për futjen në komunikacion të trenave të cilët nuk kanë qenë të paraparë me orar të lëvizjes së trenave dhe për të cilët janë kërkuar trase të jashtëzakonshme, është realizuar menjëherë.



2.1.1 Numri i trenave

Prioriteti numër një i këtij departamenti gjatë këtij tremujori ka qenë organizimi i qarkullimit të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave nëpër linjat hekurudhore.

Në tabelat vijuese janë paraqitur të dhënat mbi numrin e trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave të cilët kanë qarkulluar në kuartalin e parë të këtij viti, duke e bërë krahasimin e tyre me të njëjtën periudhë kohore të vitit 2019.

Krahasimi i trenave	Trenat e udhëtarëve			
	Numri trenave	Trenat e rregullt	Trenat ad hok	Trenat e revokuar
Viti 2020	722	720	2	190
Viti 2019	883	878	5	22
Diferenca (2020 - 2019)	-161	-158	-3	168

Krahasimi i trenave	Trenat e mallrave			
	Numri trenave	Trenat e rregullt	Trenat ad hok	Trenat e revokuar
Viti 2020	305	77	228	229
Viti 2019	516	264	252	228
Diferenca (2020-2019)	-211	-187	- 24	1

Nga tabelat e mësipërme shihet se numri i trenave të udhëtarëve në tremujorin e parë të këtij viti është 161 më i vogël në krahasim me numrin e trenave të udhëtarëve të të njëjtës periudhë të vitit paraprak. Kjo pasi që nga data 13.03.2020 është ndërprerë qarkullimi i trenave të udhëtarëve për shkak të pandemisë me COVID 19.

Sa i përket numrit të trenave të mallrave në periudhën kohore janar – mars të këtij viti kemi pasur 211 trena më pakë sesa në të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Kjo e dhënë dëshmon se kemi një rënie të transportit të mallrave gjë që edhe Operatori i Transportit Hekurudhor – TRAINKOS por edhe INFRAKOS-i si përfitues i pagesave të qasjes në binarë nga kjo kompani kanë një përfitim më të vogël nga rënia e të hyrave nga transporti i mallrave.

2.1.2 Numri i aksidenteve

Një brengë kryesore dhe njëri ndër problemet më të mëdha të këtij departamenti paraqesin rastet e jashtëzakonshme, apo aksidentet të cilat ndodhin në linjat tona hekurudhore. Në tabelën vijuese janë paraqitur aksidentet të cilat kanë ndodhur në kuartalin e parë të këtij vitit duke i krahasuar ato me të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Rastet e jashtëzakonshme	Numri total i aksidenteve	Vlera e dëmeve materiale	Numri i personave të lënduar	Numri i personave të vdekur
Viti 2020	3	2,970.00	0	2
Viti 2019	5	0.00	2	1
Diferenca (2020 - 2019)	-2	2,970.00	-2	1

Nga tabela shihet se në tremujorin (janar – mars) 2020 kemi pasur gjithsejtë 3 raste të jashtëzakonshme, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kemi dy raste të jashtëzakonshme më pakë. Në këto aksidente fatkeqësisht kemi pasur dy persona të vdekur. Vlen të ceket se të gjitha rastet e jashtëzakonshme janë të trajtuara nga komisioni profesional i përbashkët i INFRAKOS-it dhe TRAINKOS-it, si dhe Policia e Kosovës.

Është me rëndësi të theksohet se asnjëri prej rasteve të jashtëzakonshme të përmendura më lartë nuk ka ardhur si pasojë e INFRAKOS-it. Përkundër keqardhjes për secilin rast të jashtëzakonshëm, neve na bënë të lumtur fakti se ne nuk ishim fajtorë për asnjërin prej rasteve.

2.1.3 Shërbimi i qasjes në binarë

Shërbimi i qasjes në rrjet ka bërë me sukses përcjelljen kontinue të qarkullimit të të gjitha mjeteve lëvizëse nëpër rrjetin hekurudhor të INFRAKOS-it duke bërë llogaritjen dhe faturimin e pagesave të qasjes në rrjet dhe të të gjitha shërbimeve tjera shtesë të cilat i ka ofruar INFRAKOS-i për operatorin e transportit TRAINKOS dhe RAILTRANS. Në tabelat vijuese është dhënë krahasimi i të hyrave për tremujorin e parë të vitit 2020 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2019 për operatorin TRAINKOS dhe atë RAILTRANS.

Periudha kohore	Të hyrat nga trenat e udhëtarëve	Të hyrat nga trenat e mallrave	Të hyrat nga trenat ad hok	Të hyrat nga shërbimet tjera	Të hyrat totale
(Janar – mars) 2020	50,581.44	23,550.15	0.00	15,153.33	89,284.92
(Janar – mars) 2019	59,579.39	30,827.80	0.00	21,907.93	112,315.12
Diferenca (2020 – 2019)	-8,997.95	-7,277.65	0.00	-6,754.60	-23,030.20

Periudha kohore	Të hyrat nga trenat e mallrave	Të hyrat nga trenat ad hok	Të hyrat nga shërbimet tjera	Të hyrat totale
(Janar – mars) 2020	5,054.08	0.00	2,737.01	7,791.09
(Janar – mars) 2019	4,645.87	0.00	2,558.95	7,204.82
Diferenca (2020 – 2019)	408.21	0.00	178.06	586.27

Nga tabelat e mësipërme shihet se në tremujorin e parë të këtij viti për shkak të ndërprerjes së trenave të udhëtarëve dhe rënies së transportit të mallrave ka pasur një rënie të të hyrave nga Operatori i Transportit – TRAINKOS.

Kjo domosdoshmërisht paraqet një lajm të keq për INFRAKOS-in sepse kur dihet që të hyrat tona kryesore varen nga pagesat e qasjes në binarë të këtyre dy operatorëve për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, atëherë çdo rënie e të hyrave për ne paraqet një problem për shtesë financiar.

2.1.4 Terminali i mallrave

Në këtë tremujor, ngjashëm me vitin e kaluar për fat të keq numri i kontejnerëve të transportuar në terminal ka qenë zero, gjë që ka ndikuar automatikisht në rënien e të hyrave të terminalit për shërbimet e ofruara. Tanimë, kjo situatë duhet seriozisht të analizohet nga operatorët e transportit TRINKOS dhe RAILTRANS.

Periudha kohore	Numri i kontejnerëve	Të hyrat nga kranit	Të hyrat nga piruneri	Të hyrat nga fletëhyrjet	Totali i të hyrave
(Janar – Mars) 2020	0.00	0.00	2,146.00	1,710.00	3,856.00
(Janar – Mars) 2019	0.00	120.00	1,440.00	1,050.00	2,610.00
Diferenca (2020 - 2019)	0.00	-120.00	1,096.00	660.00	1,246.00

2.2 Departamenti i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore

Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2020, ky departament është marrë me mirëmbajtjen e linjave hekurudhore dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse në mënyrë që qarkullimi i trenave dhe mjeteve tjera lëvizëse të bëhet pa problem dhe me sigurinë maksimale. Përkundër vështirësive të caktuara, realizimi i detyrave të këtij departamenti ka qenë në nivelin e kënaqshëm. Në mënyrë të veçantë është punuar edhe gjatë sezonit dimërorë në pastrimin e borës dhe akullit në ndërruese, si dhe nëpër tunele ashtu që të mos rrezikohet qarkullimi i trenave.

Departamenti i Mirëmbajtjes së Linjave Hekurudhore përkundër vështirësive financiare të kompanisë ka arritur që të ruaj koherencën për nivelin e lartë të mirëmbajtjes së infrastrukturës ekzistuese hekurudhore, përfshirë këtu binarët hekurudhor me tërë infrastrukturën e tyre përkatëse, urat, tunelet, lëshesat, kanalet ujë përcjellëse, platotë për ngarkim / shkarkimin e mallrave, vendkalimet në nivel, si dhe të gjitha objektet tjera për ofrimin e shërbimeve hekurudhore.

Gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar shumë detyra, ndërsa në vijim janë prezantuar detyrat kryesore të realizuara në këtë tremujor.


2.2.1 Kontrollimet e hekurudhës dhe objekteve përcjellëse



Gjatë periudhës janar - mars 2020 është bërë kontrollimi i rregullt i hekurudhës dhe objekteve përcjellëse sipas planifikimit mujor dhe duke u bazuar në rregulloret ekzistuese. Kontrollimet janë kryer si kontrollime vizuale të hekurudhave dhe objekteve nëpër linjat hekurudhore duke ecur dhe duke evituar mangësitë e identifikuar në kohë sa më të shkurtë. Një punë e madhe është bërë edhe në përcjelljen e gjendjes së binarëve, ashtu që të mos lejohet të ndodhë asnjë aksident eventual për

shkak të binarëve hekurudhor. Përveç kësaj janë bërë edhe kontrollimet me matje të planifikuara të ndërrueseve dhe vendet e nevojshme në linjat hekurudhore si dhe kontrollimet nga mjetet lëvizëse të hekurudhës.

2.2.2 Rregullimi i binarit sipas kahes dhe niveletës me fuqi punëtore dhe makina plaser



Njëra nga punët kryesore gjatë mirëmbajtjes së linjave hekurudhore ka të bëjë me rregullimin e deformimeve të niveletës, kahes dhe planifikimi i kolerinës-balastit në linjat hekurudhore. Kështu që në mënyrë që të kemi linja të sigurt për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, gjatë këtij tremujori është bërë mirëmbajtja e rregullt e të gjitha linjave hekurudhore në funksion me makinën plaser.

2.2.3 Rregullimi i ndërrueseve sipas kahes dhe niveletës



Në këtë pozicion të punëve bëhet rregullimi i deformimeve të niveletës, kahes, pjesëve të dëmtuara dhe planifikimi i koltrinės - balastit nëpër ndërruese të stacioneve hekurudhore. Kjo punë është kryer me mjaft sukses duke përdorur makinën plaser e cila e mundëson një gjë të tillë, duke e zëvendësuar punën fizike e cila më përpara është kryer nga punëtorët. Kjo mirëmbajtje ka garantuar një qarkullim të sigurt të trenave të udhëtarëve dhe mallrave.

2.2.4 Rregullimi dhe mirëmbajtja e binarëve



Njëra ndër punët më të rëndësishme në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore ndërlidhet me mirëmbajtjen e rregullt dhe evitimin e mangësive nëpër binarët hekurudhor. gjatë këtij tremujori është bërë mirëmbajtja kontinuale e binarëve sipas planeve të veprimit të përcaktuara paraprakisht dhe po ashtu sipas nevojave të përditshme duke evituar të gjitha mangësitë e përcaktuara gjatë kohës së vëzhgimit të binarëve.

2.2.5 Rregullimi i zonave të vendkalimeve në nivel



Duke parë se shumica e aksidenteve kanë ndodhur dhe ndodhin në vendkalimet në nivel hekurudhë – rrugë, atëherë njëra nga detyrat me prioritet të lartë gjatë këtij tremujori ka qenë e ndërlidhur me rregullimin e zonës së vendkalimeve në nivel. Kjo punë është kryer me sukses dhe të gjitha vendkalimet e rregulluara tani kanë një nivel të kënaqshëm gjë që mundëson një lëvizje më të lehtë të automjeteve rrugore.

2.2.6 Mirëmbajtja e urave



Një punë e rëndësishme gjatë këtij tremujori është bërë edhe me mirëmbajtjen e urave hekurudhore të cilat paraqesin njërën ndër hallkat më të rëndësishme në zinxhirin e infrastrukturës hekurudhore. Vlen të përmendet se Departamenti i MLH-së përveç mirëmbajtjes së urave, gjatë këtij tremujori ka bërë edhe matjen e parametrave përkatës të të gjitha urave në linjat në funksion.

2.2.7 Pastrimi i borës në binarë dhe skambje



Duke marrë parasysh se zezoni dimërorë gjithnjë paraqet një problem tejet të madh në zhvillimin e komunikacionit hekurudhor sepse bëhet mbulimi i skambjeve nga bora dhe akulli, gjë që pengon qarkullimin e trenave nga njëri binar në tjetrin, departamenti i linjave hekurudhore edhe këtë tremujorë ka bërë një punë të shkëlqyer në pastrimin e skambjeve dhe një pjese të binarëve nga bora. Kjo ka mundësuar qarkullimin pa pengesë të trenave.

2.2.8 Pastrimi i borës në tunele



Përveç pastrimit të borës në stacione dhe skambje, departamenti i mirëmbajtjes së linjave hekurudhore ka bërë edhe pastrimin e rregullt të borës në linjat e hapura hekurudhore aty ku kjo ka qenë e domosdoshme, por vlen të ceket se vëmendje e posaçme i është kushtuar pastrimit nëpër tunele ku për çdo dimër krijohen shtresa të mëdha të akullit të cilat e cenojnë sigurinë e komunikacionit hekurudhor.

2.2.9 Pastrimi dhe rregullimi i lëshesave dhe kanaleve ujë përcjellëse



Departamenti i MLH-së ka bërë një punë të madhe edhe në pastrimin e kanaleve anësore dhe lëshesave nëpër të gjitha linjat hekurudhore në mënyrë që gjatë reshjeve atmosferike të mos vjen deri te vërshimi i binarëve hekurudhor.

Gjatë këtij tremujori në veçanti është intervenuar në pastrimin e kanaleve dhe lëshesave për të cilat ekziston një rrezik potencial i përmbytjeve.

2.2.10 Pastrimi dhe rregullimi i binarëve industrial




Në periudhën Janar – Mars – 2020 është bërë kontrollimi dhe mirëmbajtja e binarit industrial „Feronikeli” me të cilët është lidhë kontrata për mirëmbajtje. Nga kjo kontratë INFRAKOS-i përfiton të hyra të konsiderueshme në emër të mirëmbajtjes.

2.2.11 Lyerja dhe përpunimi i bulonave




Mirëmbajtja e pjesëve përforcuese të binarëve është punë e një rëndësie të veçantë pasi që me këtë sigurohet që binaritetë ketë parametrat e kërkuar për të garantuar sigurinë e qarkullimit të trenave. Prandaj njëra ndër punët e realizuara gjatë këtij tremujori ndërlidhet edhe me lyerjen dhe përforcimin e bulonave mbajtës të shinave në traversat e binarëve, punë kjo e cila bëhet në mënyrë kontinueale.

2.2.12 Transporti i punonjësve dhe materialit të punës



Mirëmbajtja e binarëve hekurudhor ndërlidhet ngushtë edhe me materialin e punës dhe pjesët rezeve të zëvendësimit. Këtu që edhe këtë tremujor departamenti i MLH-së ka organizuar transportin e materialit të nevojshëm dhe punëtorët në secilën pjesë të hekurudhës ku ka qenë nevoja të intervenohet për eliminimin e pengesave dhe zëvendësimin e pjesëve të ndryshme të binarëve, përfshirë edhe shinat hekurudhore.

2.2.13 Testimi i tuneleve dhe platosë në stacionin e Miradisë



Në këtë tremujor është bërë edhe testimi i tuneleve në grykën e Kaçanikut në mënyrë që të analizohen parametrat teknik të tyre për rehabilitimin e tyre në kuadër të projektit të modernizimit, si dhe kanë filluar punët në përgatitjen për ndërtimin e platosë në stacionin hekurudhor të Miradisë.

2.2.14 Rrethimi i trenit muze në Bllace



Me qenë se treni muze i vendosur në Bllace ishte dëmtuar, departamenti i Mirëmbajtjes së linjave Hekurudhore në këtë tremujor përveç detyrave tjera ka vendosur rrethojën metalike për mbrojtjen e këtij treni muze i cili ka një rëndësi të veçantë pasi që pasqyron eksodin e popullit shqiptar në vitin 1999 të dëbuar nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë.

2.3 Departamenti i veprimtarisë elektroteknike

Departamenti i Veprimtarisë Elektroteknike gjatë këtij tremujori i ka realizuar me sukses objektivat e parapara me Planin e Veprimit i cili ka dalë nga Plani i Biznesit 2020. Objektivi kryesor i këtij departamenti në tremujorin e parë të vitit 2020 ka qenë mirëmbajtja e pajisjeve SS, TK dhe EN ashtu që ato të kryejnë me sukses misionin për çka janë dedikuar. Në kuadër të këtij objektivi departamenti ka pasur aktivitet të përhershëm në evitim të shpejtë të pengesave duke intervenuar edhe jashtë orarit të punës në mënyrë që të mos ketë probleme gjatë qarkullimit të trenave.

Objektivat e departamentit të VET në këtë tremujor kanë qenë:

1. Ngritja e sigurisë së komunikacionit hekurudhor
2. Mirëmbajtja e rregullt dhe funksionale e pajisjeve SS,TK dhe EN
3. Përcjellja e Dizajn Projektit për Rehabilitim të hekurudhës.
4. Realizimi i automatizimit të tetë vendkalimeve në linjën hekurudhore Fushë Kosovë – Pejë
5. Shpenzimet buxhetore në Departament (Janar-Mars 2020)

Departamenti i VET-së i ka realizuar me sukses objektivat e parashtruara për këtë tremujor.



Meqenëse pajisjet sinjalo siguroese, telekomunikuese dhe ato të energjetikës janë të shtrira në tërë rrjetin hekurudhor, është normale që këto pajisje të kenë probleme të ndryshme për shkak të ndikimeve të palëve të treta mbi këto pajisje. Gjatë këtij tremujori kemi pasur pengesa dhe dëmtime të caktuara të stabilimenteve SS, TK dhe EN, mirëpo veprimi i shpejtë i ekipeve të mirëmbajtjes ka bërë që këto pengesa të eliminohen menjëherë, ashtu që të mos cenohet siguria e komunikacionit hekurudhor.

Gjatë këtij tremujori mund të konstatojmë me kënaqësi se të tria shërbimet e këtij departamenti kanë realizuar me sukses detyrat e parapara, kështu që pajisjet sinjalo siguroese, të telekomunikacionit dhe ato të energjetikës, edhe pse në kushte të

vështira për shkak të mungesës së pjesëve rezervë të mjaftueshme, gjatë gjithë kohës kanë qenë në funksion të plotë.

Lloji i intervenimeve për eliminimin e pengesave dhe numri i detyrave të realizuara gjatë këtij tremujori ka qenë shumë i madh, por ne në vijim do t'i përmendim disa nga detyrat kryesore të realizuara në këtë periudhë kohore:

- Është bërë kontrollimi mujor i skambjeve së bashku me departamentin e komunikacionit dhe MLH-së nëpër linjat hekurudhore në operim;
- Është bërë evitimi i pengesave në mekanizmat elektrik për vendosjen e skambjeve;
- Është bërë zëvendësimi dhe riparimi i pjesëve të dëmtuara të stabilimenteve për kontrollimin e lëvizjes së trenave;
- Është bërë rregullimi dhe riparimi i vendkalimeve automatike në nivel, sidomos pas thyerjes së gjysmë barrierave nga vozitësit e pakujdesshëm;
- Është bërë në mënyrë kontinuale riparimi i ormanëve metalik në të cilët janë të vendosura stabilimentet ss dhe kabllot e sinjalizimit;
- Është bërë intervenimi dhe riparimi i sinjaleve elektrike nëpër stacione, kurdo që për këtë ka pasur nevojë;
- Është intervenuar në mirëmbajtjen e pajisjeve të brendshme elektrotelefonike si dhe pajisjeve të furnizimit me tension duke bërë zëvendësimin e elementeve të prishura;
- Është bërë kontrollimi dhe intervenimi i rregullt në mirëmbajtjen e baterive stacionare për furnizim me energji të pajisjeve SS dhe TK;
- Është bërë zëvendësimi i menjëhershëm i kablllove të vjedhura SS nga palët e treta dhe riparimi i stabilimenteve përkatëse;
- Është bërë riparimi i defekteve në antenat e sistemit të radiolidhjeve;
- Është intervenuar në mënyrë kontinuale në evitimin e pengesave në sistemin e telefonisë nëpër zyra dhe stacionet hekurudhore;
- Është intervenuar në mirëmbajtjen dhe evitimin e pengesave në video sistemin e vrojtimit të stacioneve;
- Është intervenuar në eliminimin e pengesave në sistemin energjetik, përfshirë këtu, rrjetin e ndriçimit, instalimet elektrike, trafostacionet, gjeneratorë, e kështu me radhë;
- Janë bërë matjet e nevojshme të pajisjeve SS, TK dhe EN;
- Është punuar edhe në projektin e sigurimit të vendkalimeve automatike në linjën hekurudhore të Pejës; dhe
- Janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera sipas nevojave dhe kërkesave ditore.

Si zakonisht edhe këtë tremujor kemi pasur sfida të konsideruara, mirëpo angazhimi i të gjithëve ka qenë në nivelin e duhur, andaj të gjitha sfidat janë tejkaluar me sukses

2.4 Zyra e planifikimit dhe zhvillimit

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim gjatë periudhës tremujore (janar – mars) 2020 ka vazhduar punën për të siguruar ngritjen e performancës së kësaj zyre në funksion të shërbimit të interesave të kompanisë, si një synim i vazhdueshëm dhe me qëllim të plotësimin të kriterëve dhe nevojave për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore.

Ky Raport reflekton mbi aktivitetin e stafit të zyrës për Planifikim dhe Zhvillim përfshirë zhvillimet më të rëndësishme e veçmas ato në periudhës tremujore respektivisht për muajt Janar- Mars,2020, kemi vazhduar me punët në zbatimin e planin vjetor të punës së zyrës dhe njëkohësisht kemi përcjellë punët te cilat ishin në fazën e hartimit siç janë:

Objektivat e Zyrës

Ngritja e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore.

Ngritja e bashkëpunimit brenda kompanisë, më institucione vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të ngritjes së sigurisë dhe modernizimit të linjave hekurudhore.

Hulumtimi i zhvillimeve, të arriturave në teknologjinë e sistemeve hekurudhore dhe propozimet e mundshme për zbatimin e tyre.

Përpilimi i analizave financiare duke u mbështetur në kornizat buxhetore dhe projekte.

Aktivitetet kryesore dhe rezultate e arritura janë paraqitur në vijim:

- ➔ Ofrimin dhe mbështetjen profesionale në realizimin e kërkesave të ndryshme në nivel të kompanisë dhe detyrave të dalta nga mbledhjet e menaxhmentit.
- ➔ Angazhimi në harmonizimin e planit zhvillimor të komunës së Obiliqit me planet e Infrakos-it për planifikim hapësinor dhe zhvillim të komunës për tetë vitet e ardhshme;
- ➔ Angazhim në menaxhim të projekteve si projekt menaxher.
- ➔ Angazhimi në harmonizimin e ligjeve aktuale mbi hekurudhat me ato të BE-së;
- ➔ Është përfunduar dokumenti informata mbi linjën e re hekurudhore Kosovë – Shqipëri
- ➔ Me programin PTV Visum është punuar modelimi i kërkesës për transport për tërë rrjetin hekurudhor të Kosovës, pra është paraqitur gjendja momentale e lëvizjes së trenave, pastaj planifikimi i trenave të udhëtarëve për secilin linje/segment hekurudhorë të prezantuar në tre skenarë, ku për secilin skenar janë bërë propozime për përmirësim të rrjetit dhe ndërtim të linjave të reja hekurudhore.
- ➔ I është ofruar mbështetje profesionale Enti të Statistikave të Kosovës.

- Është duke punuar në hartimi të një koncept dokumenti të ri për linjën hekurudhore Klinë Prizren.
- Jemi duke hulumtuar zhvillimet teknologjike për te hartuar një koncepte dokumente te digjitalizimin e pronës.
- Hartimi i një koncepte dokumenti mbi gjendjen aktuale edhe evidentimin e ekspoziteve në “Muzeun e Hekurudhave të Kosovës” edhe mundësin e regjistrimit si muze industrial i Kosovës.
- Është duke u punuar në futjen e direktivave dhe rregulloreve të mbetura të BE-së në tabela.
- Janë duke u analizuar dokumente me pyetje rreth vendkalimeve në nivel rrugë hekurudhë, monitorimin e kushteve në të cilat gjendet infrastruktura hekurudhore si dhe sistemin e menaxhimit të aseteve të infrastrukturës hekurudhore.

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim përveç punëve dhe detyrave të përshkuara më lartë, ka vazhduar të kryej edhe punët që janë paraparë në planin e veprimit të kësaj zyreje për tremujorin e parë të këtij viti, si dhe është angazhuar në punë tjera të nevojshme për nevojat e INFRAKOS-it.

Përkundër sfidave të caktuara, ne mund të konstatojmë se performanca e Zyrës për Planifikim dhe Zhvillim gjatë tremujorit të parë të këtij viti ka qenë në nivelin e duhur dhe se kjo zyre do të vazhdon t'i realizoj me sukses detyrat e parapara edhe në kuartalin vijues.

2.5 Departamenti i administratës

Departamenti Administratës së Përgjithshme ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar edhe gjatë këtij tremujori të vitit 2020 në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij departamenti dhe kompanisë në tërësi. Në secilin sektor dhe shërbim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara dhe këtë ia kemi arritur me mjaft sukses.

2.5.1 Zyra e Personelit

Ka pasur angazhim të vazhdueshëm në administrimin e personelit dhe detyrave tjera, me synim arritjen e objektivave, uljen e moshës mesatare dhe përmirësimin e strukturës gjinore. Detyrat e realizuara të këtij sektori në mënyrë të detajuar janë paraqitur në pikën 1.2 të këtij raporti.

Kjo zyrë në mënyrë aktive ka punuar dhe punon në menaxhimin e resurseve njerëzore duke realizuar me sukses të gjitha detyrat e parapara me planin e biznesit, respektivisht me planin e veprimit të kompanisë.

2.5.2 Shërbimi i logjistikës

Shërbimi i Logjistikës ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar gjatë këtij tremujori në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij shërbimi. Secila njësi dhe komplet shërbimi ka punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara, me gjithë vështirësitë që jemi ballafaquar në këtë periudhë për shkak të gjendjes dhe vjetërsisë së veturave që kemi.

Edhe përkundër kësaj, mirëmbajtja e veturave gjatë kësaj periudhe ka përmbushur me sukses objektivat. Është bërë servisimi i rregullt i të gjitha veturave. Është bërë regjistrimi dhe sigurimi në afatet e parapara, është bërë kompletimi me të gjitha pajisjet përcjellëse dhe është bërë pastrimi dhe furnizimi i rregullt me naftë, pastaj përcjellja e fletudhëtimeve dhe kilometrave të kaluara për çdo veturë veç e veç dhe për të gjitha së bashku.

2.5.3 Shërbimi i mirëmbajtjes së objekteve

Kryesisht janë bërë punë të rregullta rreth nxehjes qendrore dhe ndezjes dhe pastrimit të kaldajave. Zhvendosjen dhe pastrimin e radiatorëve me rrjetin përcjellës në disa zyre në ndërtesën e drejtorisë dhe elektros.

Është mirëmbajtja kontinue e të gjitha objekteve dhe inventarit brenda zyrave sipas kërkesave ditore dhe planeve të veprimit.

Janë bërë edhe shumë intervenime dhe riparime të ndryshme në tërë rrjetin hekurudhor sipas nevojave dhe kërkesave të shërbimeve të ndryshme të kompanisë..

2.6 Departamenti i MP, SHMP & IT

Departamenti i Marrëdhënies me Publikun, Shkollim, Mbrojtje në Punë dhe Teknologji Informative është departament i cili ka punuar në mënyrë kontinueale për realizimin e detyrave të punës edhe në tremujorin e parë të këtij viti. Sikurse edhe departamentet tjera edhe ky departament ka pasur sfidat e veta, mirëpo falë angazhimit dhe përkushtimit maksimal, është arritur një sukses i mirë.

Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë sektorët vijues:

- ➔ Sektori për marrëdhënie me publikun dhe marketing;
- ➔ Sektori për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë; dhe
- ➔ Sektori për teknologji informative

Në secilin sektor dhe shërbim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara dhe me gjithë vështirësitë dhe sfidat e natyrave të ndryshme, nuk ka munguar rezultati i pritur. Andaj puna e stafit të këtij departamenti dhe angazhimi i tyre ka ndikuar që ne të jemi gjithnjë një nivelin e detyrës duke menaxhuar me kujdes të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet e rëndësishme të kompanisë. Është shumë normale që gjatë punës kemi pasur edhe sfida të caktuara, por falë angazhimeve tona çdo gjë është tejkaluar me sukses.

2.6.1 Sektori për marrëdhënie me publikun dhe marketing

Sektori për marrëdhënie me publikun dhe marketing me të gjitha sfidat që është përballur gjatë kësaj periudhe vazhdimisht e ka përcjell dhe e ka zbatuar planin e biznesit në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të aplikuara në kompani.

Zyra për informim dhe përkthime ka zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm së veçantë gjatë tremujorit janar – mars 2020 në përpjekje për të përmbushur objektivat e parapara.

Në fushën e marrëdhënieve me media dhe publikun duke e përfshirë edhe përkthimet e nevojshme të kësaj kompanie ne kemi arritur që edhe më tej të jemi më të kërkuar në përkthime dhe në mbrojtjen e imazhit në pasqyrimin e kompanisë në përgjithësi.

2.6.2 Sektori për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë

Në këtë periudhë kohore menaxhimi i rregullt i sektorit për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë ka qenë në nivelin e dëshirueshëm duke i realizuar me sukses detyrat e parashtruara me Planin e Veprimit.

- ➔ Shkollimi i rregullt dhe periodik, trajnimi dhe zhvillimi i personelit të Infrakos-it
- ➔ Trajnimet për stafin e kompanisë;
- ➔ Po ashtu kompanisë Ferronikel jemi duke i kryer shërbime në lidhje me shkollimin permanent të stafit ekzekutiv për transport hekurudhor;
- ➔ Organizimi dhe mbikëqyrja e kontrollimeve të rregullta mjekësore të punëtorëve;
- ➔ Mbrojtja e shëndetit, ambientit dhe siguria në punë;

- Mbikëqyrja dhe inspektimi;
- Mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore; dhe
- Punë dhe detyra tjera sipas kërkesës dhe nevojave ditore.

2.6.3 Sektori i teknologjisë informative

Si në çdo sektor tjetër edhe në sektorin e teknologjisë informative është bërë punë e zellshme në kryerjen e detyrave dhe obligimeve që na obligon plani i biznesit për vitin 2020. Në veçanti janë realizuar këto detyra:

- Mirëmbajtje e rregullte efektive e pajisjeve dhe rrjetës së Teknologjisë Informative
- Ngritja e nivelit të sigurisë së sistemit të Teknologjisë Informative
- Janë montuar, instaluar dhe konfiguruar pajisje kompjuterike sipas nevojës dhe kërkesave të zyrtarëve të Infrakos-it.
- WSUS Serverit përkatësisht konzollës për update ia kemi larguar (fshire) filet e vjetër dhe të pa nevojshëm për instalim.
- Kemi intervenuar në WSUS Server pas problemeve që janë paraqitur me marrje të updateve nga Serverët dhe kompjuterët.
- UPS 3000VA në rackun e serverëve ia kemi ndërruar bateritë dhe gjithashtu i kemi testuar.
- Kemi arritur që t'i rifunksionalizojmë 3 server fizik dhe 7 virtual për ri-startimit në mënyrë të dhunshme me datën 24.01.2020
- Kemi qenë në gjendje gatishmërie në sistemin dhe rrjetën e kompjuterike për shkak të ndërprerjeve të rrymës elektrike dhe të mos funksionimit (ndaljes) se gjeneratorit herë pas here për ftohje të tij sidomos gjatë muajit Mars.
- Është ri-funksionalizuar antena wireless për internet në ndërtesën e Elektros për shkak të dëmtimit nga era e fuqishme.
- Është ri instaluar Fire Power e ASA Firewallit Fizik

2.7 Departamenti për pronë dhe standarde

Raporti tremujor i departamentit të pronës dhe standardeve është përpiluar duke u bazuar në punën e dy sektorëve të cilët janë në përbërje të këtij departamenti:

- Sektori i patundshmërisë; dhe
- Sektori i standardeve.

Gjatë këtij tremujori angazhimi i të dy sektorëve ka qenë në nivelin e kërkuar, andaj edhe realizimi i detyrave të planifikuara sipas planit të biznesit, respektivisht sipas planeve të veprimit është realizuar me sukses.

2.7.2 Sektori i patundshmërisë

Raporti tre mujor për Janar - Mars nga Departamenti i Pronës dhe Standarde është përpiluar duke u bazuar në hapësirën e veprimit dhe mundësisë që kemi pasur si Departament.

Në tre mujorin e parë sektori i pronës ka dërguar njoftime për shkresa të gjithë klientëve rreth pagesës që kanë obligime ndaj Infracos-it. Është përgatitur një listë për klientët që të dërgohen në përmbarues për shkak të borxheve.

Është në shqyrtim e sipër vazhdimi i kontratave në Pejë pasi për klientët të cilët e shfrytëzojnë pronën e INFRAKOS-it. Gjatë këtij tremujori janë realizuar këto kontrata:

Numri i kontratave të nënshkuara 43
Numri i kontratave në pritje ka qenë 17
Numri i kontratave në mungesë të klientëve janë 2

Problemi kryesor gjatë këtyre tre muajve ka qenë i ndërlidhur me borxhet që shfrytëzuesit e pronës ia kanë INFRAKOS-it. Kështu ndër borxhlinjtë më të mëdhenj janë:

- Komuna e Mitrovicës me 48,625.88 €
- Komuna e Ferizajt me 69,017.21 €
- Restorant Kallaba me 50,443.02 €
- Arda Rei me 20,626.42

Këta janë disa nga klientët që duhet të shqyrtohen dhe barazohen gjatë muajit të ardhshëm kështu që do të veprimit me prioritet në zgjidhjen e këtyre borxheve.

2.7.3 Sektori i standardeve dhe sigurisë

Sektori për standarde dhe siguri gjatë kësaj periudhe kohore ka zhvilluar kontakte me ARH-në për t'iu përgjigjur kërkesave të tyre duke raportuar për numrin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, numrin e personave të vdekur dhe të lënduar si dhe dëmet materiale për vitin 2019 dhe këtë tremujor.

Është punuar në mbledhjen dhe përpunimin e shënimeve dhe raporteve të ngjarjeve të jashtëzakonshme, me qëllim të përgatitjes së raportit vjetor të sigurisë për vitin 2019.

Janë zhvilluar takime me anëtarët e komisioneve të ngjarjeve të jashtëzakonshme, ku janë diskutuar problemet dhe sfidat që i kanë komisionet për hetimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme.

Bazuar në kërkesën e drejtorit të departamentit zyrtari për mbrojtjen e mjedisit edhe në këtë tremujor ka vazhduar në mbështetje të ekipeve të sektorit të pronës dhe ka qenë në shërbim të tyre në aktivitete të përditshme duke verifikuar ndërhyrjet në pronën e INFRAKOS-it, grumbullimin dhe përpunimin e informatave rreth uzurpatorëve të cilët e shfrytëzojnë pronën tonë me fokus në komunën e Prishtinës.

Gjatë kësaj periudhe janë vizituar të gjitha stacionet duke verifikuar nëse ka ndonjë ndryshim nga inspektimi i fundit i cilësisë së mjedisit në stacione. Vlen të theksohet se gjendja e cilësisë së ambientit nuk është e kënaqshme, nga kjo mund të themi se si stacione më të ndotura janë ai i Hanit të Elezit dhe stacioni në Pejë si shkak rrjedhjes së makinerive respektivisht lokomotivave dhe të cilat qëndrojnë kohë pas kohe aty. Në konsultim me punëtorët dhe shefin e stacionit kemi informata se rrjedhjen e derivateve në stacionin Hani i Elezit e shkaktojnë më shumë lokomotivat të cilat vijnë nga ana e Maqedonisë.

2.8 Departamenti i prokurimit

Departamenti i Prokurimit gjatë tremujorit të parë të këtij viti i ka kushtuar kujdes të veçantë zbatimit të procedurave të furnizimit të kompanisë, duke garantuar kështu stabilitetin financiar, por edhe duke i plotësuar nevojat e kompanisë për punë të rregullt. Në bazë të planifikimit të prokurimit i cili është marrë nga projektet e aprovuara në buxhet, Departamenti i Prokurimit ka iniciuar procedurat sipas kohës së planifikuar për tenderim të projekteve dhe zbatimin e tyre. Prandaj, gjatë kësaj periudhe kohore departamenti i prokurimit është marrë me dy lloje të projekteve:

- Projektet kapitale të realizuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
- Projektet e furnizimit të realizuara nga Buxheti INFRAKOS-it.

2.8.1 Projektet kapitale nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

Sipas të dhënave të cilat i menaxhon Departamenti i Prokurimit, nga mjetet e Buxhetit të Kosovës akoma nuk janë zhvilluar aktivitetet e përgatitjes së dokumenteve përkatëse lidhur me publikimin e projekteve kapitale të cilat priten të realizohen sipas planifikimit paraprak të përcaktuar me Planin e Biznesit 2020.

2.8.2 Projektet e furnizimit nga Buxheti i INFRAKOS-it

Varësisht nga kërkesat e njësive kërkuese dhe duke u bazuar në procedurat e prokurimit, gjatë kësaj periudhe kohore është realizuar me sukses furnizimi i të gjitha pjesëve rezervë dhe materialit tjetër të kërkuar nga të gjithë sektorët e INFRAKOS-it.

Departamenti i Prokurimit pas pranimit të kërkesave të aprovuara, ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe ka nënshkruar kontratat për furnizim për 17 (shtatëmbëdhjetë) projekte të ndryshme, për trembëdhjetë prej të cilave janë nënshkruar kontratat dhe janë realizuar blerjet, ndërsa katër prej tyre janë në procedurë.

Vlen të përmendet se të gjitha projektet e realizuara për këtë periudhë kohore janë kryer në tërësi duke iu përmbajtur rregullave dhe procedurave ekzistuese të prokurimit.

2.9 Kontrollori i brendshëm

Ky raport i kontrollorit të brendshëm përfshinë aktivitetet tremujore të kontrollimit të të gjithë sektorëve ekzekutiv për periudhën tremujore (janar – mars) të këtij viti.

- Kontrolli në stacione
- Kontrolli në vijat hekurudhore ,gjendja tyre.
- Kontrollin e stafit ekzekutiv

Përcjellja e trenave është bërë sipas planit të kontrollit dhe për vërejtjet e konstatuara janë hartuar raportet e nevojshme dhe janë dërguar në baza javore dhe janë dërguar me kohë.

Gjatë muajve janar, shkurt, mars janë bërë kontrollime, analiza në stacione, duke raportuar në formë ditore, javore dhe mujore për gjendjen në stacione dhe të shërbimeve në hekurudhat e Kosovës.

Shkollimi i rregullt në Sektorin për Rregullimin e Komunikacionit është mbajtur nga shefat e stacioneve sipas plan programit për vitin 2020 për stafin e Sektorit të komunikacionit.

Organizimi i lëvizjeve të trenave të mallrave ka qenë në nivel, janë organizuar të gjitha lëvizjet e planifikuara nga Operatorët e transportit si dhe për nevojat e Infra kos-it, për muajt e lartcekur në vitin -2020.

Gjatë muajve të kaluar, është përcjellë dhe është bërë kontrolli teknik i ndërrueseve në tërë linjën hekurudhore nga Departamenti i MLH-ës në bashkëpunim me Sektorin e Komunikacionit dhe Shërbimin e SS-it.

Është bërë kontroll i vijës hekurudhore F. Kosovë – Pejë dhe për këtë vijë hekurudhore janë hartuar raportet e nevojshme ne baza javore dhe janë dërguar tek Krye shefit Ekzekutiv .

Është bërë kontroll i vijës hekurudhore F. Kosovë – H. Elezit dhe për këtë vijë hekurudhore janë hartuar raportet e nevojshme ne baza javore dhe janë dërguar tek Krye shefi Ekzekutiv .

Gjatë muajit shkurt në relacionin Gurëz-Kaçanik-Hani Elezit ka pasur mbyllje të linjës, ku janë transportuar mallra për nevojat e projektit nga ora 08:30 – 17:40 me kërkesë dhe mbikëqyrje nga Departamenti i MLH-ës dhe punëkërkuesit me kon traktor.

Gjatë muajt mars nuk pati transport të udhëtareve për shkak te masave të marra, por transporti mallrave ka vazhduar, ku është bërë transporti i shinave për projektin por ka pasur dhe transport të mallrave të tjera.


Për kullimin e ujët nga te reshurat atmosferike , është bërë fotografimi i gjendjes ekzistuese dhe vazhdon krahasimi , dhe për gjendjen ne teren në raportet javore janë dërguar dhe foto te gjendjes .

Është bërë kontroll në stacionet Miradi, Lipjan, Bablak, Gurëz, Kaçanik, H. Elezi, Bardh, Drenas, Klinë, Pejë, Kastriot, Vushtrri, Mitrovicë dhe për te gjitha kontrollet që janë bërë në stacionet hekurudhore dhe linjat hekurudhore janë hartuar raportet javore dhe janë dërguar tek K. Ekzekutiv .

Gjatë muajve Janar- Mars 2020 ka pasur tri ngjarje të jashtëzakonshme. Fatmirësisht nuk ka pasur fatalitet në njerëz, të tri rastet kanë ndodhur për shkak të pakujdesisë dhe mos respektimin e shenjave .

Vlen të ceket se përkundër problemeve të caktuara, departamentet ekzekutive i kanë kryer me sukses detyrat e parapara me planet e veprimit për tremujorin e parë të vitit 2020.

Performanca financiare e INFRAKOS-it



3. Performanca financiare e INFRAKOS-it

Në periudhën (janar – mars) 2020, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA, përkundër një numri të konsideruar të vështirësive ka pasur një angazhim maksimal drejt realizimit të detyrave të parapara në drejtim të ruajtjes së funksionimit të kompanisë duke pasur parasysh gjendjen jo të mirë financiare e cila na ka përcjellë edhe në këtë periudhë kohore.

Për fat të keq në këtë tremujor nuk është bërë as subvencionimi i pritur kështu që kjo e ka vështirësuar tej mase situatën edhe ashtu të vështirë financiare. Sidomos problem në vete paraqet edhe ndërprerja e transportit të udhëtarëve nga data 13 mars për shkak të pandemisë me COVID 19, gjë që ka ndikuar edhe më shumë në rënien e të hyrave nga pagesat e qasjes në binarë.

Për sqarim më të mirë, në tabelën vijuese është bërë prezantimi i të hyrave dhe shpenzimeve për këta tre muaj, duke e bërë krahasimin me të njëjtën periudhë kohore të vitit paraprak.

Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve për kuartalin e parë 2020		Realizimi 2019	Realizimi 2020	Buxheti 2020	Diferenca	Diferenca
		A	B	C	B - A	B - C
TË HYRAT	Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit	119,519.94	97,076.01	124,500.00	-22,443.93	-27,423.99
	Të hyrat nga qiraja	132,873.11	161,945.03	187,500.00	29,071.92	-25,554.97
	Të hyrat tjera	59,435.97	24,690.31	37,500.00	-34,745.66	-12,809.69
	Subvencionimi i diferencës së rrjetit	190,462.45	0.00	300,000.00	-190,462.45	-300,000.00
	Të hyrat totale	502,291.47	283,711.35	649,500.00	-218,580.12	-365,788.65
SHPENZIMET	Pajisjet	1,433.01	9,679.82	6,850.00	8,246.81	2,829.82
	Harxh. e lokal. ndërtesave	11,179.90	8,759.81	31,200.00	-2,420.09	-22,440.19
	Energjia elektrike	36,976.28	34,656.37	64,000.00	-2,319.91	-29,343.63
	Nafta	9,436.55	5,012.19	12,750.00	-4,424.36	-7,737.81
	Vajrat, lysterësit, etj.	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Materiali harxhues operativ	5,412.70	4,516.78	8,010.00	-895.92	-3,493.22
	Riparimet	2,107.73	1,571.86	11,750.00	-535.87	-10,178.14
	Shërbimet operative	824.57	8,699.68	730.00	7,875.11	7,969.68
	Udhëtimet zyrtare	790.00	140.00	1,294.00	-650.00	-1,154.00
	Marketingu dhe publikimet	2,110.32	2,552.17	120.00	441.85	2,432.17
	Mat. i zyrës dhe konsumues	3,439.97	2,890.57	13,000.00	-549.40	-10,109.43
	Telefoni / mail / interneti	3,550.09	2,679.53	6,371.00	-870.56	-3,691.47

Shpenz. e rrezikshmërisë	4,465.36	2,336.50	7,500.00	-2,128.86	-5,163.50
Reprezetntac./konsumueset	1,798.42	472.37	7,570.00	-1,326.05	-7,097.63
Sigurimi	3,232.20	4,790.03	13,630.00	1,557.83	-8,839.97
Stafi i jashtëm	0.00	0.00	3,000.00	0.00	-3,000.00
Stafi dhe punëtorët	521,356.98	517,733.44	576,400.00	-3,623.54	-58,666.56
Shpenzimet tjera operative	7,862.51	510	20,850.00	-7,352.51	-20,340.00
Gjithsejtë shpenzimet	615,976.59	607,001.12	785,025.00	-8,975.47	-178,023.88
Diferenca (të hyrat – shpenzimet)	-113,685.12	-323,289.77	-135,525.00	-209,604.65	-187,764.77

1. Të hyrat

Të hyrave e INFRAKOS-it për muajt (janar – mars) 2020 janë prezantuar në tabelën e mësipërme dhe si zakonisht këto të hyra përbëhen nga të hyrat e pagesave të qasjes në binarë (shfrytëzimi i rrjetit), të hyrat nga patundshmëria, të hyrat tjera dhe të hyrat nga subvencionimi. Në vijim është bërë përshkrimi i të hyrave të realizuara për secilin segment duke e bërë krahasimin e tyre me buxhetin e planifikuar dhe vitin paraprak.

1.1 Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit

Në muajt (janar – mars) 2020 janë realizuar 97,076.01 €, apo 27,423.99 € më pak sesa shuma e buxhetit të planifikuar prej 124,500.00 €. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar kur këto të hyra ishin 119,519.94 €, del se janë realizuar 22,443.93 € më pakë. Kjo situatë ka ardhur si pasojë e mosrealizimit të transportit në këtë periudhë kohore nga TRAINKOS-i, si dhe ndërprerjes së qarkullimit të trenave të udhëtarëve nga 13 marsi 2020 për shkak të COVID 19

1.2 Të hyrat nga qiraja

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 161,945.03 € e që krahasuar me buxhetin 187,500.00 €, del se ne kemi realizuar 25,554.97 € më pakë të hyra se sa ka qenë e planifikuar për këtë periudhë, ndërsa krahasuar me vitin e kaluar 132,873.11 €, del se kemi realizuar 29,071.92 € më shumë të hyra.

1.3 Të hyrat tjera

Për këtë periudhë janë realizuar 24,690.31 €, ndërsa të planifikuara kanë qenë 37,500.00 €. Pra kemi realizim prej 12,809.69 € më të vogël nga planifikimi, ndërsa krahasuar me vitin 2019 ku kishim të hyra në vlerën prej 59,435.97 €, për këtë periudhë kohore kemi 34,745.66 € më pakë të hyra.

1.4 Subvencionimi

Për tremujorin e parë subvencionimi i planifikuar për diferencës në mes të pagesave nga qasja në rrjet dhe kostos direkte të mirëmbajtjes prej 300,000.00 €, nuk është realizuar, mirëpo ky subvencion është bërë në muajin prill 2020

2 Shpenzimet

2.1 Shpenzimet e planifikuara dhe realizuara

Sa i përket shpenzimeve mund të konstatojmë se shpenzimet e realizuara në këtë periudhë janë 607,001.12 € që në krahasim me shpenzimet e planifikuara 785,025.00 €, janë për 178,023.88 € më të vogla. Nëse këto shpenzime i krahasojmë me vitin 2019, vlera e të cilave ishte 615,976.59 €, atëherë del se në krahasim me vitin paraprak ne kemi shpenzuar 8,975.47 € më pakë se në të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Nga tabela e mësipërme shihet se shumica e shpenzimeve kanë qenë më të vogla sesa shpenzimet e planifikuara. Të vetmet tejkalime të shpenzimeve janë bërë tek pajisjet për 2,829.82 €, shërbimet operative për 7,969.68 € dhe marketingu dhe publikimet për 2,432.17 €.

3 Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve

Bazuar në tabelën e mësipërme të të hyrave dhe shpenzimeve shihet se diferenca në mes të të hyrave të realizuara 283,711.35 € dhe shpenzimeve të realizuara 607,001.88 € është për 323,289.77 €, më e vogël sesa të hyrat e realizuara. Sikurse kësaj vlere t'i shtoheshin të hyrat e parapara nga subvencioni (300,000.00 €), atëherë kjo diferencë do të ishte 23,289.77 €,

Procedurat gjyqësore



4. Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it

Zyra Ligjore e Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës ShA - INFRAKOS gjatë periudhës janar – mars të vitit 2020 i ka pasur një numër të konsideruar të seancave gjyqësore në të cilat ka dhënë maksimumin për mbrojtjen e kompanisë.

Gjatë kësaj periudhe tre mujore përfaqësuesit ligjor të ndërmarrjes kanë pasur të caktuar një numër më të vogël të seancave gjyqësore krahasuar me periudhën paraprake. Në këto seanca janë zhvilluar çështje – konteste të natyrave të ndryshme dhe të gjitha janë mbajtur dhe kanë qenë të përfaqësuara nga zyrtarët ligjor të autorizuar të kompanisë.

Vlen të përmendet se gjatë muajit Mars 2020 ka pasur vetëm disa seanca në fillim të muajit, pasi që më pas është pezulluar aktiviteti i rregullt i gjykatave për shkak të Covid19. Gjykatat gjatë kësaj periudhe punojnë vetëm në raste urgjente.

Zyra Ligjore e INFRAKOS-it gjatë punës tremujore Janar- Mars ka zhvilluar një punë të pandërprerë dhe profesionale në përfaqësimin e kompanisë me qëllim të mbrojtjes së pronës, infrastrukturës hekurudhore dhe interesit të kompanisë nga uzurpatorët dhe dëmtuesit, qoftë nga personat fizik dhe juridik duke përfshi edhe komunat në të cilat shtrihet infrastruktura hekurudhore. Përkundër shumë sfidave është bërë një punë e madhe për përfaqësim adekuat dhe profesionale në gjykata.

Aktualisht në Zyrën Ligjore kemi 439 lëndë në procedura ligjore dhe 174 lëndë në procedurë përmbarimore në total prej 613 lëndëve. Gjatë kësaj periudhe stafi i Zyrës Ligjore ka hartuar një numër të madh të shkresave të ndryshme juridike, ka marr pjesë në 38 seanca gjyqësore dhe ka kontaktuar në vazhdimësi të gjithë përmbaruesit privat të angazhuar më lëndët e Infrakos. Gjate kësaj periudhe kanë arritur 6 vendime në favor të kompanisë dhe tre në disfavor të kompanisë. Dy nga këto vendime kanë pasur të bëjnë me kompensime të kontributeve pensionale dhe pagave jubilarë, ndërsa vendimi tjetër ka pasur të bëjë me obligimet tatimore ndaj komunës së Prishtinës. Praktikisht te tri këto raste nuk është dashur fare të lejohet të shkojnë në Gjykatë pasi që nuk kemi pasur asnjë bazë për kundërshtim të tyre. Megjithëse gjatë kësaj periudhe kemi qenë në një fazë tranzitore të ndërrimit të udhëheqjes së zyrës, puna e saj është karakterizuar me një përkushtim dhe angazhim profesional, gjithnjë duke u bazuar në autorizimet, detyrat dhe obligimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore të akteve të brendshme të ndërmarrjes si dhe zbatimit të dispozitave ligjore. Pas tejkalimit të pandemisë dhe normalizimit të proceseve të punës do të hartojmë raport të detajuar lidhur me të gjitha vendimet gjyqësore gjatë kësaj periudhe dhe periudhës në vijim.

Angazhimi i Zyrës Ligjore të INFRAKOS-it gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë i madh dhe kështu do të vazhdohet gjatë tërë kohës edhe pse numri i lëndëve dhe kontesteve të cilat i trajton kjo zyre është tejet i madh.

Procedurat gjyqësore në K2



5. Procedurat gjyqësore të INFRAKOS-it për kuartalin vijues

Në kuartalin vijues INFRAKOS-in e presin kontestet gjyqësore të natyrës së njëjtë të cilat janë të ndërlidhura me pagesat e borxheve ndaj kompanisë, uzurpimin e pronës, çështjet banesore, dëmet e infrastrukturës, vërtetimin e pronave, etj. Ne jemi të vetëdijshëm se mund të ketë edhe ndonjë kontest të ri të natyrës tjetër, por pa marrë parasysh llojin dhe numrin e kontesteve, Zyra Ligjore e INFRAKOS-it është e gatshme që me përkushtim t'i mbrojë interesat e kompanisë.

Transaksionet financiare



6. Transaksionet financiare në kuartalin e parë

Për periudhën (janar – mars) 2020, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS nuk ka pasur ndonjë transaksion të madh të mjeteve i cili vlen të përmendët. Pra, gjatë këtyre tre muajve janë bërë vetëm pagesat për shpenzimet operative, si dhe pagesat për furnizime të cilat nuk kanë pasur ndonjë vlerë të madhe e cila do të vlente të përmendët. Çka është më me rëndësi, të gjitha transaksionet janë bërë sipas ligjeve dhe rregulloreve tjera në fuqi për menaxhimin e financave.

Ngritja e performancës



7. Sugjerimet për ngritjen e performancës

INFRAKOS-i si Menaxher i Infrastrukturës Hekurudhore prioritetin kryesor në tremujorin e parë të këtij viti e ka pasur mirëmbajtjen e infrastrukturës ashtu që organizimi i trafikut hekurudhor të bëhet pa pengesa dhe në nivelin më të lartë të sigurisë. Sfidat me të cilat jemi përballur në këtë tremujor kanë qenë shumë të mëdha dhe akoma mbesin të tilla, përderisa të mos ndërmerren hapat e duhur nga institucionet përgjegjëse qeveritare. Ne kemi qenë dhe jemi të angazhuar maksimalisht për kryerjen e detyrave tona, andaj duke ditur rëndësinë e madhe që ka hekurudha besojmë që edhe institucionet përkatëse të bëjnë detyrat e veta.

Si zakonisht, edhe në tremujorin e parë të këtij viti problemi numër një ndërlidhet me mospagesën e subvencionimit të kërkuar nga Qeveria, me çka po cenohet funksionimi i kompanisë. Për këtë arsye kërkohet me urgjencën më të madhe angazhimi i menjëhershëm i të gjitha institucioneve përgjegjëse për zgjidhjen e problemit financiar të INFRAKOS-it. Këtu bëhet fjalë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit së bashku me MEPTINIS, të cilat sipas Ligjit mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063 janë përgjegjëse për nënshkrimin e kontratës financiare pesëvjeçare me INFRAKOS-in. Ne kërkojmë nga këto dy ministri që të rishikojnë draft kontratën financiare pesëvjeçare (2021 – 2025) të dërguar nga INFRAKOS-i dhe të bëjnë nënshkrimin e saj, ashtu që të mos cenohet funksionimi i transportit hekurudhor, ndërsa në ndërkohë të shqyrtojnë dhe miratojnë kërkesën tonë për subvencionimin e INFRAKOS-it për vitin 2020.

Duke ditur që gjendja në tremujorin e parë sa i përket të hyrave ka qenë shumë e keqe dhe atë kryesisht pa fajin e INFRAKOS-it, sepse të hyrat kryesore të kësaj kompanie varen prej operatorëve të transportit (TRAINKOS dhe RAILTRANS), atëherë sugjerimet tona për tremujorin vijues janë sa vijon:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik të realizojnë obligimet e tyre ligjore për subvencionimin e plotë të INFRAKOS-it për vitin 2020 duke i mbuluar kështu në tërësi kostot direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës
- Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik të nënshkruajnë marrëveshjen financiare pesëvjeçare (2021 – 2025) e cila është hartuar në bazë të Planit shtatëvjeçar të biznesit (2020 – 2025)
- TRAINKOS si operator i transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave të angazhohet shumë më tepër në rritjen e vëllimit të transportit duke ofruar kështu shërbime cilësore dhe efikase
- Institucionet komunale dhe ato gjyqësore të angazhohen shumë më tepër në mbrojtjen e pronës së INFRAKOS-it e cila uzurpohet dhe keqpërdoret nga personat e ndryshëm fizik dhe juridik
- Ministria e Infrastrukturës njëherë e përgjithmonë të hartoj, miratoj dhe zbatoj strategji të mirëfillta zhvillimore për sektorin hekurudhor.
- INFRAKOS-i të vazhdojë me urgjencë ndërmarrjen e të gjitha masave për mbledhjen e borxheve të cilat të tjerët i kanë ndaj kësaj kompanie
- INFRAKOS-i të vazhdojë me urgjencë reduktimin e të gjitha shpenzimeve me përjashtim të atyre të cilat janë të lidhura me sigurinë e komunikacionit hekurudhor.